



KONKURS PUBLIK PËR DIZAJNIMIN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, shpall konkurs publik për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahoveci, të themeluara me Rregullore të Kuvendit të Komunës në Rahovec me Nr. Prot. 327/22 të datës 31.05.2022.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Kriteret e dizajnit të titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve:

- Të jetë origjinale, unike dhe të mos jetë imitim i ndonjë logoje ekzistuese.
- Të ketë pasqyrim artistik ;
- Të jetë e veçantë, kreative, kualitative dhe profesionale;
- Të jetë lehtësisht e kuptueshme;
- Të përçojë mesazh të qartë;
- Të jetë e dallueshme dhe t'i rezistojë kohës;
- Të jetë lehtë e përdorshme; material të bronzit;
- Të ketë shpjegim të secilit detaj të propozuar në dizajn;

Dekoratat, çmimet, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet:

- Dekorata "Qytetar nderi i Komunës së Rahovecit"
- Dekorata " Nderi i Komunës së Rahovecit"
- Dekorata "Ukshin Hoti"
- Dekorata për humanizëm "Dr. Ali Sokoli"
- Medalja e Lirisë
- Çmimi letrar "Sulejman Krasniqi"
- Çmimi "Bujku i vitit"
- Çmimi " Lexuesi i vitit"
- Çmimi "Artisti i vitit"
- Medalja "Sportisti i vitit"
- Mirënjohje dhe falënderime

Për dekorata vlera e përcaktuar është: ----- 1800 €

Për çmime vlera e përcaktuar është: -----600 €

Për medalje, mirënjohje e falënderime vlera është:----- 600 €

Mënyra e aplikimit:

Punimet duhet të dorëzohen në pliko të mbyllura me shifër dhe pa emër të autorit në CD, (në të kundërtën do të diskualifikohen) dhe po ashtu e shtypur në kopje fizike. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit.

Aplikacioni duhet të ketë mbishkrimin “Për dizajnin ideor të titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve ”

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën emëposhtme:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Rruga Dëshmorët e Pashtrikut p.n ;

Sporteli i pranimit nr.7, objekti i Komunës

Kush mund të konkurojë:

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë artistët nga Komuna e Rahovecit.

Konkursi është i natyrës garuese

Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Vërejtje: Konkurentët duhet të bazohen në rregulloren komunale për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit të aprovuar nga Kuvendi Komunal më datë 31.05.2022.

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/06/Rregullore-per-dhenien-etitujve-te-nderit-mirenjohjeve-dhe-dekoratave-te-Komunes-se-Rahovecit.pdf>

Data e shpalljes 21.10.2022

Data e fundit për aplikim 10.11.2022

